

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE
“EI-MEDIA” SHPK**

Sot, në Tiranë, më datë 06.01.2021 (dymijë e njëzet e një), në praninë personale të Ortakut të Vetëm Themelues të shoqërisë:

Z. Emirjon SENJA, i biri i Nazmiut dhe Nexhmijes, i datëlindjes 30.12.1986, lindur në Elbasan, dhe banues në Tiranë, në adresën: Rr. Kongresi i Manastirit, Pallati Fratari, identifikuar me letërnjoftimin me nr. personal I61230008G.

Nënskruhet ky Akt Themelimi, në të cilin Ortaku Themelues shpreh vullnetin të themelojë shoqërinë tregtare “Ei-Media” SHPK, me kushtet si vijon:

**NENI 1
Emri i shoqërisë**

- 1.1. Emri i shoqërisë do të jetë “Ei-Media” SHPK (në vijim referuar si “Shoqëria”).
- 1.2. Ortaku i vetëm themelues i shoqërisë gjëzon përgjegjësi të kufizuar deri në limitin e kontributit përkates në kapitalin e shoqërisë, të përfaqësuar në kuota.

**NENI 2
Forma e shoqërisë**


- 2.1. Forma e shoqërisë Ei-Media do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar).
- 2.2. Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

**NENI 3
Selia e shoqërisë**

- 3.1. Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën: Rruga Aleksander Moisiu, Ish Kinostudio.
- 3.2. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose qytet tjeter brenda Republikës së Shqipërisë, si dhe ka të drejtë të hapë degë ose zyra përfaqësimi të saj kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

**NENI 4
Kohëzgjatja e Shoqërisë**

- 4.1. Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.



NENI 5 Objekti i veprimtarisë

5.1. Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, por duke mos u kufizuar në të:

- 5.1.1. Investim në fushën e menaxhimit dhe hapjes së strukturave të ndryshme në fushën e medias audiovizive, kryesisht radio, televizione, portale interneti, reklama, agjenci lajmesh, produksione televizive (emisionet, etj.), transmetime analoge/digitale, etj., duke marrë përsipër menaxhimin në total të burimeve njërzore dhe marrëdhënieve me klientët (menaxhimi i programeve te ndryshme televizive, publikime online, emisionet e ndryshme etj.) apo marrëdhëniet me të tretët.
- 5.1.2. Çdo aktivitet tjeter plotësues dhe ndihmës që ka si qëllim ofrimin e çdo shërbimi tjeter, në rast se rezultojnë të dobishme dhe/ose të nevojshme për përmbushjen e objektit kryesor, si dhe çdo aktivitet tjeter që konsiderohet fitimprurës dhe në interes të shoqërisë pavarësisht fushës së veprimtarisë.

NENI 6 Kapitali i Shoqërisë

- 6.1. Kapitali i shoqerisë është në vlerën 100 (njëqind) Lekë, i përbërë nga 1 (një) kuotë, me vlerë nominale prej 100 (njëqind) Lekë.
- 6.2. Ortaku themelues zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit themeltar, pra 100% të tij në vlerën 100 (njëqind) Lekë.
- 6.3. Kapitali themeltar është nënskruar nga ortaku i vetëm themelues në total dhe do të paguhet prej tij.

NENI 7 Organet Drejtuese

7.1. Bazuar në dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve/Mbledhja e Ortakut të Vetëm — organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori — organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.

7.2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

NENI 8 Administrimi

8.1. Shoqëria do të administrohet nga Administratori i saj, i cili zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.



- 8.2. Administratori i Shoqërisë është **Z.Emirjon SENJA**, i biri i Nazmiut dhe Nexhmijes, i datëlindjes 30.12.1986, lindur në Elbasan, dhe banues në Tiranë, në adresën: Rr. Kongresi i Manastirit, Pallati Fratari, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin me nr.personal I61230008G, i cili zgjidhet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë rizgjedhje.
- 8.3. Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, apo nga një ose disa persona të autorizuar prej tij.
- 8.4. Administratori i shoqërisë ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 9
Ligji i aplikueshëm

9.1. Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si dhe parashikimet e Statutit të nënshkruar nga Ortaku Themelues.

NENI 10
Regjistrimi

10.1. Shoqëria do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga administratori dhe/ose një/disa person(a) të autorizuar prej tij për këtë qëllim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.


NENI 11
Dispozitat përfundimtare

11.1. Akti i Themelimit hartohet në 4 (kater) kopje të njëjta në gjuhen shqipe dhe nënshkruhet me vullnet të plotë, të lirë e të pacënuar nga ortaku i vetëm themelues i Shoqërisë.

“EI-MEDIA” SHPK

ORTAK THEMELUES

Z. Emirjon SENJA



A handwritten signature in black ink, appearing to read "Emirjon SENJA". Below the main name is a stylized, cursive initial "E". A horizontal line or flourish is drawn underneath the signature.